1

NIS FUNDI

Kur një ditë e cila, sipas teje, i bie të jetë ditë e mërkurë, të duket që në fillim si e diel, me siguri ka diçka serioze që nuk shkon. E pata këtë përshtypje që çastin kur u zgjova.

E megjithatë, pasi m'u kthjellua disi mendja, nisa të kisha dyshime. Sepse, në fund të fundit, edhe pse kisha një ndjesi të fortë se qeshë zgjuar më vonë se zakonisht, fare mirë mund të qe e vërtetë dhe e kundërta.

Sidoqoftë, ndenja të prisja i mbushur me dyshime dhe, pa shkuar shumë, pata provën e parë objektive: m'u bë sikur që larg dëgjova një orë që ra tetë herë. I ngrita veshët, dyshues. Dhe ja një tjetër orë që kumboi fortë dhe e vendosur. Pa asnjë ngutje, dhe ajo ra tetë herë. Atëherë e kuptova se kishte vërtet diçka që s'shkonte.

Qe thjesht një rastësi që unë s'qeshë i pranishëm të shihja sesi mori fund bota që kisha njohur deri atëherë, për pothuajse tridhjetë vjet me radhë. Kur rri e mendoj, më duket se qe e shkruar që unë të mbijetoja. Është krejt e natyrshme që përherë do ketë njerëz të shtruar në spital dhe atë ditë, falë ligjësisë së rastësisë, unë kisha gati një javë i shtruar në spital. Fare mirë, kjo mund të më kishte ndodhur një javë më parë dhe po të kishte qenë ashtu, tani unë s'do të isha duke shkruar këto rreshta; në fakt, s'do isha fare. Pra, fati e deshi që atë ditë jo vetëm që isha i shtruar në spital, por dhe t'i kisha sytë, madje dhe gjithë kokën, të fashuara, gjë për të cilën duhet t'i jem mirënjohës atij (kushdo qoftë) që vendos për të tilla gjëra. Por, të them të vërtetën ato çaste unë po e vrisja mendjen vetëm se ç'dreqin po ndodhte, sepse kisha aq kohë aty sa ta kuptoja se në një spital gjëja më e shenjtë (vetëkuptohet pas kryeinfermieres) është gjithnjë orari.

Pa orar, një vend i tillë, thjesht s'funksionon dot. Deri atëherë e dija që çdo mëngjes, fiks në orën shtatë pa tre minuta, do vinte dikush për të më larë e rregulluar, në pritje që të më sillnin për të ngrënë mëngjesin. Kjo qe një nga arsyet përse e vlerësoja aq shumë faktin që kisha një dhomë më vete, përndryshe, po të më kishin vënë në pavijonin publik, punë të tilla bëheshin së paku një orë më herët. Por atë ditë dëgjoja orët që binin nga të gjitha anët e, megjithatë, askush s'po dukej.

Ka të ngjarë që kjo gjë do më kishte bezdisur, pavarësisht nga ç'ditë qe, por më duhet të them se e mërkura, 8 mars, për mua qe një ditë krejt e veçantë. Atë ditë mezi po prisja sa të përfundonin punët rutinë të mëngjesit, sepse qe dita kur duhej të vinin për të më hequr fashat.

E pata disi të vështirë, derisa arrita të gjeja zilen, së cilës i rashë fort duke e mbajtur të shtypur për pesë sekonda të mira, që ta merrnin vesh mirë ç'mendoja për ta.

Mbajta vesh se mos dëgjoja ndonjë reagim.

Atëherë, kuptova se përjashta po ndodhte diçka edhe më e çuditshme nga ç'e pandehja. Nga zhurmat që dëgjoheshin por dhe ato që s'dëgjoheshin, dukej si ditë e diel, madje më e diel se vetë e diela, ndërkohë që tashmë unë qeshë tërësisht i bindur se ishte e mërkurë.

Asnjëherë s'kisha arritur dot ta kuptoja përse e kishin ngritur spitalin St. Merry pikërisht aty ku kryqëzoheshin dy rrugët kryesore, në një lagje të mbushur plot me zyra, duke ia acaruar kësisoj vazhdimisht nervat pacientëve. Por sidoqoftë, për fatlumët të cilët sëmundja s'i bënte të ishin veçanërisht të ndjeshëm ndaj zhurmës së vazhdueshme të trafikut, ky vend paraqiste edhe avantazhe sepse edhe pse s'lëvizje dot nga shtrati, prapë s'e ndjeje veten, si të thuash, të shkëputur plotësisht nga rrjedha e jetës. Zakonisht, dëgjohej uturima e autobusëve të linjës së West End-it

teksa rrekeshin ta kalonin semaforin me dritë të verdhë, ndonëse shpesh, nga zhurma e frenave dhe breshëria e kërcitjeve të skapamentos, kuptoje se s'ia kishin dalë dot mbanë. Pastaj, dëgjoje gumëzhimën e makinave që viheshin prapë në lëvizje. Herë pas here kishte ndonjë pauzë, një goditje e shurdhët e papritur, e pasuar nga një ndalim i përgjithshëm, që për dikë në kushtet e mia qe një torturë e vërtetë sepse ishe i detyruar ta gjykoje aksidentin thjesht nga niveli i sharjeve që pasonin.

Por, atë mëngjes, gjithçka qe ndryshe nga zakonisht. Ndryshe në një mënyrë që të shqetësonte, sepse gjithçka qe e mistershme. S'dëgjohej gjëmimi i rrotave, as gumëzhima e autobusëve; në realitet, unë s'arrija të dëgjoja as dhe zhurmën e një makine të vetme. As frenat, as buritë, as trokthin e kuajve të rrallë që kalonin nganjëherë aty. As hapat e rrëmujshëm të njerëzve që shkonin në punë.

Mbajta vesh me vëmendje një copë here që, me ç'llogarita, duhej të qenë rreth dhjetë minuta: s'dëgjova veç disa hapa hezitues që sikur hiqeshin zvarrë, si dhe ca zëra që diku larg s'merrej vesh se ç'bërtisnin, ndërsa një çast dhe dënesën histerike të një gruaje. S'dëgjohej as gugatja e pëllumbave, as cicërima e ndonjë harabeli. Asgjë tjetër, veç zukamës së telave të elektrikut që dridheshin nga era.

Po më kapte një ndjesi e keqe. E njëjta ndjesi që kisha provuar disa herë kur isha i vogël dhe më bëhej sikur në qoshet e errëta të dhomës sime rrinin fshehur përbindësha të tmerrshëm dhe s'guxoja të lëvizja nga vendi nga frika se mos që poshtë krevatit dilte ndonjë gjë që të më kapte këmbën, dhe atëherë s'guxoja as të zgjasja dorën për të hapur dritën, nga frika se mos ajo gjëja më sulej. U përpoqa ta luftoj këtë ndjesi njëlloj siç kisha bëra kur isha i vogël. Po nuk ishte e lehtë.

Më në fund arrita ta mblidhja disi veten dhe u mundova të arsyetoja. Ç'e bën trafikun të ndalojë? Zakonisht, kur rruga bllokohej, kjo ndodhte për shkak të punimeve. Fare e thjeshtë. Por, vazhdova me vete, sikur të qe ashtu, do duhej të duroja zhurmën e trapanove pneumatike që gjithsesi, do qe një variacion për veshët e shkretë të pacientëve. Por problemi qe, e vazhdova arsyetimin, se s'dëgjohej as edhe një lloj zhurme sado e largët, as zhurma e makinave, as fërshëllima e ndonjë treni, as boria e ndonjë rimorkiatori. As dhe një zhurmë e vetme, derisa nisi kori i orëve që tregonin se kishte vajtur ora tetë e një çerek.

U ndjeva fort i tunduar që të hidhja një sy shpejt e shpejt (natyrisht jo më shumë se aq), sa për të krijuar një ide se ç'dreqin po ndodhte. Por arrita ta mbaja veten. E para e punës, sepse një gjë e tillë s'do të qe aspak e lehtë, si ç'mund të duket. Sepse s'qe fjala vetëm për të ngritur pak fashën nga sytë, në fakt, unë jo vetëm që isha i gjithi i fashuar, por qeshë i mbushur me shtupa. Por arsyeja kryesore qe që kisha frikë ta bëja. Pasi ke qenë plotësisht i verbër për më shumë se një javë, kjo është një përvojë që të bën të tregohesh mjaft i kujdesshëm kur bëhet fjalë për sytë. Ishte e vërtetë se qe dita kur duhej të vinin të më hiqnin fashat, por për këtë nevojitej një dhomë me një ndriçim të veçantë të mugët dhe vetëm pasi nga vizita do rezultonte se gjendja e syve qe tërësisht e kënaqshme, do mund të m'i linin të pa mbështjellë. Pastaj, s'e dija se si do të shkonin punët … Po sikur shikimi të më qe dëmtuar përgjithnjë? Sikur të mos isha më në gjendje të shikoja! …

Lëshova një të sharë dhe i rashë prapë ziles. Por, me ç'dukej, askush s'ia vinte veshin asaj. Po e humbisja durimin. Atëherë e vendosa se duhej të bëja diçka.

Po të dilja në korridor e të bërtisja e bëja zhurmë, mendova, dikush duhet të vinte, qoftë edhe për të më thënë se ç'mendonte për mua. E hoqa mbulesën dhe zbrita nga shtrati. S'e kisha parë asnjëherë dhomën në të cilën ndodhesha, por me të dëgjuar e kisha krijuar pak a shumë një ide nga ç'anë duhet të qe dera, e megjithatë, s'e pata aspak të lehtë ta gjeja. Dukej sikur rruga për të mbërritur deri aty qe e mbushur plot me pengesa nga më absurdet e të panevojshmet; megjithatë më në fund ia dola mbanë, ndonëse këtë e pagova duke lënduar gishtin e madh të këmbës, si dhe duke përplasur jo dhe aq fort kërcellin e këmbës. Më në fund, dola në korridor.

"Hej!" bërtita. "Më sillni mëngjesin. Dhoma dyzet e tetë!"

Për një çast s'ndodhi asgjë. Pastaj dallova shumë zëra që bërtisnin të gjithë njëherësh. Dukej sikur ishin qindra, ndonëse s'dallohej qartë as edhe një fjalë. Dukej sikur dikush kishte vënë një disk

që riprodhonte zhurmën e një turme, të një turme dashakeqe. Befas më lindi dyshimi i çmendur se mos ndoshta, kur qeshë në gjumë, dikush më kishte marrë e më kishte çuar në një çmendinë dhe se vendi ku gjendesha s'ishte aspak spitali St. Merry. Zërat që dëgjoja s'më dukeshin aspak normalë. E mbylla derën me nxitim dhe, ashtu qorrazi, u ktheva prapë në shtrat që atë çast m'u duk i vetmi vend i sigurt dhe pa telashe në atë botë të pakuptueshme që më rrethonte. Si për të ma përforcuar këtë ide, u dëgjua një zhurmë që më bëri të ngrija në vend pikërisht në çastin kur bëra të mbulohesha. Që poshtë nga rruga u ngrit një britmë e çmendur që të fuste tmerrin. U dëgjua tri herë, por dhe pasi u zhduk, prapë më bëhej sikur ajri vazhdonte të dridhej prej saj.

Më hynë të dridhurat. Ndjeva ballin nën fasha të më dërsinte. Atëherë u binda se po ndodhte diçka e frikshme. S'qeshë më në gjendje të duroja ta ndjeja veten aq të izoluar dhe të pafuqishëm. Duhej të merrja vesh ç'po ndodhte rreth meje. Ngrita duart tek fashat, por me të prekur kapëset, ndalova … S'kisha guximin që ashtu fill i vetëm, të merrja vesh që operacioni për të më shpëtuar sytë mund të mos kishte dalë me sukses. Po dhe sikur operacioni të kish patur sukses, a s'do qe punë me zarar t'i lija sytë zbuluar?

I ula duart dhe u mbështeta prapë në shtrat. Isha shumë i nxehur me veten dhe lëshova nëpër dhëmbë ca të shara idiote.

U desh të kalonte një copë herë e mirë që të arrija t'i shihja gjërat nga një këndvështrim tjetër dhe të nisja ta vrisja mendjen për ndonjë shpjegim të mundshëm. S'gjeta asnjë. Por, sidoqoftë, u binda përfundimisht se ishte vërtet e mërkurë, sepse një ditë më parë kishte qenë ditë krejt e veçantë dhe e dija se, sido që qe, që atëherë s'mund të kishte kaluar më shumë se një natë.

Nëse kërkoni në arkiva, keni për të zbuluar se ditën e martë, më datë 7 maj, orbita e Tokës kaloi përmes një reje të përbërë nga fragmentet e një komete. Po deshët, besojeni; miliona vetë e besuan. Ndoshta, qe vërtet ashtu. Unë vetë s'jam në gjendje të provoj asgjë. Sepse, unë vetë s'pashë ç'ndodhi; por, sigurisht, një ide e krijova. Faktikisht, e vetmja gjë që unë di për atë mbrëmje është se m'u desh ta kaloja i shtrirë në shtrat, duke dëgjuar të tjerët të rrëfenin për atë që, sipas atyre që shikonin, qe spektakli më madhështor qiellor i parë ndonjëherë.

E megjithatë, deri atëherë askush s'kishte dëgjuar të flitej ndonjëherë për atë të ashtuquajtur kometë, apo fragmentet e saj.

S'arrija dot të kuptoja ç'kuptim kishte ta transmetonin në radio atë që po ndodhte, kur çdokush që qe në gjendje të ecte, të hiqej zvarrë apo që mund ta mbanin të tjerët, kishte dalë në rrugë, apo në mos në rrugë, nëpër dritare për të shijuar falas shfaqjen më madhështore të fishekzjarrëve të parë ndonjëherë. Sidoqoftë, ngjarja u transmetua në radio, gjë që më bëri ta ndjeja edhe më shumë se ç'donte të thoshte të mos shikoje.

Në lajmet e asaj dite kishin njoftuar se një natë më parë në qiellin e Kalifornisë qenë shfaqur disa drita të mistershme me ngjyrë të gjelbër të shndritshme. Por meqë në Kaliforni është një vend ku gjithnjë ndodhin aq shumë gjëra, askush s'ia kishte venë shumë veshin këtij lajmi. Por, kur më pas nisën të vinin lajme të tjerë, atëherë njerëzit nisën të flisnin dhe ideja e fragmenteve të kometës ngjiti.

Përshkrime të netëve të ndriçuara nga meteorë të gjelbër që, siç thuhej, 'herë herë binin në formë rrebeshi aq të dendur sa të dukej sikur i gjithë qielli niste të rrotullohej', zunë të mbërrinin nga gjithë anët e Paqësorit. Dhe dora-dorës që nata zhvendosej në drejtim të perëndimit, shkëlqimi i dritave s'erdhi aspak duke u pakësuar. Aty-këtu ndodhte që ndonjë prej këtyre flakërimave të gjelbra e përshkonte qiellin edhe përpara se të kishte rënë errësira. Në lajmet e orës gjashtë, folësi, duke folur për këtë dukuri, i kështilloi të gjithë të mos e humbnin rastin për të parë një skenë të tillë të mahnitshme. Ndër të tjera ai përmendi dhe se, me ç'dukej, ajo që po ndodhte po ndërhynte seriozisht në transmetimet me valë të shkurtra në distanca të mëdha, por se në valët e mesme, ku do të transmetohej një emision i posaçëm për atë që po ndodhte, ashtu si dhe për televizionin, tani për tani s'kishte probleme.

Të gjithë në spital ishin aq të emocionuar sa s'më besohej që ndokush tjetër, natyrisht veç meje, do ta humbiste rastin për të parë një spektakël të tillë.

Dhe si të mos mjaftonte radioja, dhe infermierja që më solli për të ngrënë darkën, donte të më tregonte se ç'po ndodhte.

"I gjithë qielli është mbushur me yje që bien", më tregoi. "Të gjithë krejt të gjelbër. I bëjnë fytyrat të duken aq të zbehta sa të trembin kur i sheh. Kanë dalë të gjithë përjashta, po nganjëherë ndriçimi bëhet aq i fortë, sa të duket sikur është ditë. Po, se ç'kanë një ngjyrë të çuditshme dhe nganjëherë, ndonjë nga dritat e mëdha është aq e fortë sa të vret sytë kur e sheh. Me sa thonë, s'është parë kurrë diçka e tillë. Sa keq që s'i sheh dot, ëh?"

"Po, po," ia preva unë shkurt me një ton disi të bezdisur.

"Në pavijone i kemi hapur perdet që të gjithë të kenë mundësi të shohin," vazhdoi ajo. "Sikur të mos kishe këto fashat, që këtu ku je do kishe pamje të shkëlqyer."

"Ashtu," ia bëra.

"Po sidoqoftë, përjashta duhet të jetë më mirë. Thonë se janë me qindra mijëra që kanë dalë nëpër parqe e përgjatë Tamizit për të parë qiellin. Ca kanë hipur dhe nëpër çati e tarraca."

"Sa mendohet se do të vazhdojë?" pyeta unë me durim.

"S'e di. Por thonë se tani ndriçimi s'është më aq i fortë sa ç'qe më parë, në vende të tjera. Por, në fakt, dhe sikur të t'i kishin hequr sot fashat, prapë s'e besoj se do të linin të shikoje. Në parim, duhet të tregohesh mjaft i kujdesshëm. Ca nga këto flakërimat janë kaq të forta … Ato … Uuuuuh!"

"Ç'ndodhi?" pyeta.

"Ishte një aq e fortë sa e gjithë dhoma u bë e gjelbër. Sa keq që s'e pe!"

"Vërtet," thashë. "Tani bëhu vajzë e mbarë e ik."

U mundova të dëgjoja ç'po thoshte radioja, por prej saj s'vinin veçse të njëjtat 'uuuh' dhe 'ooooh' të ca zërave që flisnin për 'një spektakël të mrekullueshëm' e 'fenomen unikal', saqë pak nga pak nisi të më duket sikur bëhej fjalë për një festë të madhe ku ishin ftuar të gjithë, përveç meje. Meqë radioja e spitalit kishte vetëm një program, s'e ndërroja dot për të dëgjuar ndonjë gjë tjetër sa për të kaluar kohën. Sidoqoftë, pas pak kuptova se spektakli qe në të përfunduar. Spikeri kështilloi këdo që s'kish patur mundësi të shihte spektaklin, të nxitonte, përndryshe do të pendohej për tërë jetën. Më në fund u mërzita dhe e mbylla radion. Gjëja e fundit që dëgjova qe se llambadari i madh qe duke u zvogëluar me shpejtësi dhe, me ç'dukej, kishte të ngjarë që brenda pak orësh do të qemë jashtë zonës ku mund të shiheshin copëzat e kometës.

S'kisha pikë dyshimi se të gjitha këto kishin ndodhur një natë më parë; përndryshe, po të kishte kaluar më shumë kohë, tani do ndjeja më shumë uri. Epo mirë, atëherë ç'po ndodhte? Mos ndoshta i gjithë spitali, apo dhe i gjithë qyteti, s'e kishte marrë akoma veten pas një nate të tillë?

Pikërisht atë çast mendimet m'i ndërpreu kori i orëve, të afërta e të largëta, të cilat njoftonin se kishte vajtur ora nëntë.

I rashë ziles fort, si ndonjë i çmendur, për herë të tretë. Ndërsa po prisja pa luajtur vendit, që matanë portës u dëgjua një si mërmërimë. Dukej sikur përbëhej nga rënkime, zhurma e diçkaje që rrëshqiste, që hiqej zvarrë, ndërkohë që herë pas here dëgjohej nga larg ndonjë zë që ngrihej mbi të tjerët.

E megjithatë, s'u duk asnjeri. Atëherë e vendosa të hiqja fashat.

Sidoqoftë, më duhet ta them se diçka më bën nder, sepse dhe në rrethana të tilla s'e humba toruan dhe fashat s'i hoqa duke i çjerrë si ndonjë i çmendur. Pata aq mend sa, përpara se të nisja të zbërtheja kapëset e fashës, zbrita nga shtrati dhe vajta të ulja grilat.

Më në fund, i hoqa fashat dhe, kur kuptova se qesh në gjendje të shihja në gjysmerrësirë, ndjeva një lehtësim që s'e kisha provuar kurrë më parë. Pasi u sigurova që s'kishte asgjë të fshehur poshtë krevatit, vajta bllokova portën, duke vënë një karrige pas dorezës. Pas kësaj, u ndjeva më mirë. Ndenja ashtu një orë të mirë derisa pak nga pak sytë m'u mësuan me dritën e ditës. Më në fund,

kuptova se falë shpejtësisë me të cilën më qe dhënë ndihma e parë pas aksidentit, si dhe të kurimit që më kishin bërë në atë spital të bekuar, i kisha sytë fare mirë.

Por, megjithatë, ende s'po dukej asnjeri.

Në sirtarin e poshtëm të komodinës gjeta një palë syze të errëta që, me ç'duket, i kishin lënë aty për t'i përdorur kur të më duheshin. U tregova i kujdesshëm dhe i vura, përpara se t'i afrohesha dritares. Meqë pjesa e poshtme e dritares s'hapej, pamja që shihja që aty ishte e kufizuar. Hodha sytë poshtë dhe arrita të dalloja dy persona që po ecnin në rrugë në një mënyrë të çuditshme. Por ajo që më bëri më shumë përshtypje dhe që më befasoi, qe qartësia me të cilën i shihja gjërat, madje dhe çatitë që dukeshin në largësi, përtej godinave përballë. Dhe atë çast vura re se nga oxhaqet, të vegjël apo të mëdhenj, s'dilte tym …

Rrobat e mia i gjeta në dollap të varura me rregull. Pasi u vesha, po më dukej vetja disi më normal. Në paketë kishte akoma ca cigare. Ndeza një dhe i thashë vetes se, ndonëse padyshim e gjithë situata qe e çuditshme, s'kishte arsye përse të më kapte paniku.

Tani s'e kam të lehtë të kujtoj ato që mendoja ato ditë. Tanimë u mësuam të mbështetemi më shumë tek vetja, por aso kohe pjesa më e madhe e gjërave s'qe veçse thjesht një rutinë, duke qenë se gjithçka qe aq shumë e ndërlidhur. Secili prej nesh thjeshtë luante rolin e vogël që i qe caktuar, ndaj dhe s'qe e vështirë që ato që në të vërtetë s'qenë veçse shprehi dhe zakone, t'i merrje për ligjësi të natyrës, gjë që sigurisht bënte që çdo prishje e kësaj rutine, të të dukej mjaft shqetësuese.

Pasi ke kaluar thuajse gjysmën e jetës tënde me një ide të caktuar për rregullin, s'të mjaftojnë vetëm pesë minuta për t'u orientuar në një botë të re. Kur tani sjell ndërmend se si qe e organizuar bota atë kohë, habitem kur kujtoj sa shumë gjëra jo vetëm që s'i dinim, por as që e kuptonim që s'i dinim. Aso kohe, praktikisht, unë s'dija asgjë për shumë nga gjërat më të zakonshme, për shembull, s'e dija si vinte deri tek ne ushqimi që hanim, nga vinte uji që pinim, si thureshin e qepeshin rrobat që vishnim, si ia bënin për të hequr ujërat e zeza të qytetit që ky të mbetej i shëndetshëm. Atëherë, jeta jonë mbështetej mbi një mori specialistësh, secili prej të cilëve, kush më mirë e kush më keq, qe i zoti të kryente punën e vet. Ndaj dhe atë çast s'më besohej të qe e vërtetë që spitali të ishte plotësisht i çorganizuar. Isha i bindur se thjeshtë duhej ta kishin harruar dhomën 48.

Sidoqoftë, pasi dola prapë te porta dhe i hodha një sy korridorit, m'u mbush mendja se çfarëdo që të kishte ndodhur, bëhej fjalë për diçka që s'kishte të bënte vetëm me pacientin e dhomës numër 48.

Aty për aty s'pashë asnjeri, megjithëse që larg dëgjohej një mërmërimë e përhapur zërash. Ndjehej dhe një si zhurmë këmbësh që hiqeshin zvarrë dhe herë, pas here, ndonjë zë që kumbonte më i lartë se të tjerët në korridoret e zbrazët, por sidoqoftë, asgjë që të krahasohej me poteren e mëparshme. Kësaj here s'bërtita. Bëra disa hapa përpara me kujdes …përse i kujdesshëm? As vetë s'e di. Di vetëm se diçka më bënte të tregohesha i kujdesshëm.